



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DEVOLL
SEKTORI I PROKURIMEVE PUBLIKE

Bilisht më _____.____.2022

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMINE SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

PROÇES-VERBAL PËR HARTIMIN E KRITEREVE

OBJEKTI I PROKURIMIT: "Përmirësim i banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pafavorizuara" me fond limit: 27 650 357 (njezet e shtate milion e gjashtëqind e pesedhjetë mijë e treqind e shtatedhjetë e pese) leke pa tvsh

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Punime ndërtimi për shtëpi

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 "Për prokurimin publik", nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", autoriteti/enti kontraktor, Bashkia Devoll, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;

e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;

gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.

i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/Enti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një Bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit/entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP 162/2020 "Per prokurimin publik", dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Kapaciteti ligjor i operatorëve ekonomikë:

Sipas shtojcës 8.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1.Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2019, 2020 dhe 2021, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit që prokurohete fondit limit te kontrates qe po prokurohet.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 2 b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vlera e marzhit te xhiros se kerkuar ne kufirin e percaktuar si me siper konsiderohet tregues i rendesishem per kapacitetin financiar te Operatorit Ekonomik Ofertues, duke marre ne analize edhe faktin se vlera e fondit limit eshte e nje kufiri te ulet dhe iu jep mundesine nder te tjera edhe operateve ekonomik te vegjel dhe te mesem te kene akses ne oferte.

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2019, 2020, 2021, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve ne perputhje me Ligjin nr.10091,date 05.03.2009 "Per auditimin ligjor,organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar", i ndryshuar, Kreu V, neni 41, pika c. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është vendosur referuar nenit 43, pika 4 te VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" I ndryshuar , si dhe bazuar në Nenin 77 pika 3, e LPP nr.162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", si dhe Ligjin nr.10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, Kreu V, neni 41, pika c.i cili parashikon se: "Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm

2.2.3 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një dokument që vërteton se ka plotësuar të gjitha **detyrimet e taksave dhe tarifave vendore**, lëshuar nga Pushteti Vendor , **për vitin 2022**.

Ky kriter do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, që OE i ka shlyer detyrimet e taksave dhe të tarifave vendore për vitin 2021, do të dorëzohet vetëm nga operatori ekonomik i shpallur fitues përpara lidhjes së kontratës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në kërkesat specifike të Ligjit nr 9632 datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore" i ndryshuar.

2.3 Kapaciteti teknik

2.3.1 Përvojë e suksesshme në ekzekutimin e të paktën:

a- punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50 % e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

-Për të vërtetuar përvojen e mëparshme duhet të paraqiten:

-Nëse kontrata është realizuar me institucione shtetërore: Formulari i vlerësimit i shoqëruar me:
-Kontratë punimesh; -Situacion përfundimtar; -Akt-kolaudimi; -Procesverbal për marrje në dorëzim të punimeve të kryera.

-Nëse kontrata është realizuar me subjekte private: Formulari i vlerësimit i shoqëruar me:
Kontratën, situacionin përfundimtar, aktin e kolaudimit, lejen e përdorimit, faturën tatimore të deklarimit të objektit në organet tatimore.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura për përvojen e suksesshme e bën ofertën të kualifikueshme.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 39, pika 5 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik". Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat 50 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose jo më të vogël se dyfishi i vlerës së fondit limit të objektit të prokurimit për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit.

2.3.2 Liçensa profesionale e shoqërise për realizimin e punimeve, objekt i kontratës:

- **NP-1 A** (Punime Germimi në toke)
- **NP-2 B** (Ndertime civile dhe industriale)

- **NP-3 A** (Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada)
- **NS-1 A** (Punime për prishjen e ndërtimeve)
- **NS-4 A** (Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese)
- **NS-18 A** (Punime topogjeodezike)

-Për Operatorët e huaj të bëhet njehsimi i licencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Institucionit perkates , ne plotesimin te licensave profesionale te kerkuara per ekzekutimin e kontratës .

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar , si dhe ne Vendimin e Keshillit të Ministrave nr.42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndertimi”, i ndryshuar me VKM nr 92 .DT 19.02.201 ku jane te disiplinuar procedurat perkatese te licensimit te subjekteve qe ushtrojn veprimtari ne fushen e ndertimit .

Pikat e licensave jane percaktuar ne baze te zerave te pershkruara ne preventivin e projektit.

Kategoria e kërkuar	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
NP-2	Ndertime civile dhe industriale	1 Prishje mur tulle me pastrim 2 Transport I mbetjeve mbas prishjes 3 Suva brenda mur guri h~4m me pompe, llaç perzier M 25 4 Tavan rrjete teli + suva 5 Dritare d/alumini dyfish xham. 6 Dyer d/alumini dopjo xham.	B	33180429 lek > 20,000,000 lek

		<p>9 Çati vendi zakonshme HD~8m, mbuluar, tjegulla marseleze</p> <p>10 Trare tavani te sharruar</p> <p>11 Germim themele e plinta b>2m, ekskavator me goma, kova 0.25m3 shkarkim toke</p> <p>12 Trare themeli monolit b/a C - 16/20</p> <p>13 Kollona b/a monolite C - 16/20, h ~ 4 m</p> <p>14 Trare e arkitrare b/a C - 16/20, h ~ 4 m</p> <p>15 F V hekur betoni periodik Ø > 10 mm</p> <p>16 F V hekur betoni periodik Ø 6 - 10 mm</p> <p>17 Brez b/a C 16/20, h ~ 8 m</p>		
NS-1	Punime për prishjen e ndërtimeve	1)Prishje mur tulle me pastrim	A	< 20,000,000 lek
NP-3	Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada	<p>3 Suva brenda mur guri h~4m me pompe, llaç perzier M 25</p> <p>4 Tavan rrjete teli + suva</p> <p>5 Dritare d/alumini dyfish xham.</p> <p>6 Dyer d/alumini dopjo xham.</p> <p>9 Çati vendi zakonshme HD~8m, mbuluar, tjegulla marseleze</p>	A	< 20,000,000 lek
NS-4	Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese	<p>Suva brenda mur guri h-4m me pompe, llaç perzier M 25</p> <p>Dyer d/alumini dopio xham.</p> <p>F.V dyer druri</p>	A	< 20,000,000 lek

N.P. 1	(Punime gjermimi në tokë.Konsiderohen gjermimet, sistemimet dhe ndryshimet në volum të tokës, të realizuara me çfarëdo lloj mjeti, pavarësisht nga natyra e terrenit që do të gjermohet ose sistemohet vegjetale, argjilore, ranore, zhavorrishte ose shkëmbore.)	Gjermim themele e plinta b>2m, ekskavator me goma, kova 0.25m ³ shkarkim toke	A	< 20,000,000 lek
N.S-18	Punime topogjeodezike	Punime rilevimi per ndertimin e banesave te reja	A	< 20,000,000 lek

2.3.3 Kandidati ofertues duhet të përcaktojë drejtuesin teknik të punimeve në objekt i cili duhet të jetë i përfshirë në listpagesat e shoqërise, shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtëm;

- a) Kontratë pune
- b) Diplomë
- c) CV

Ky kriter do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues për drejtuesin teknik do të dorëzohet vetëm nga operatori ekonomik i shpallur fitues.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Drejtuesi i projektit është përgjegjës për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës.

2.3.4 Nje punësim mesatar për periudhën **Maj 2022 – Korrik 2022**, i të paktën **45** (dyzet e pese) personave të vërtetuar me ;

- a) Vërtetim të lëshuar nga autoritetet përkatëse, në mënyrë elektronike , ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj;

- b) Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhen e kërkuar shoqëruar me formularet e deklarimit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore.

Ky kriter do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, që OE i disponon punonjësit e mësipërm, do të dorëzohet vetëm nga operatori ekonomik i shpallur fitues përpara lidhjes së kontrates.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Konkretisht: Në përcaktimin e numrit të punonjësve specialisti i fushës ka bërë një analizë bazuar tek faktorët, si volumet dhe kategoritë e punimeve, kualifikimi i punonjësve, grafiku i punimeve, zërat e punimeve dhe orët e punës etj.. sipas manualit të çmimeve të ndërtimit miratuar me VKM Nr.629, date 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”. Në këtë kontekst, autoriteti kontraktor ka përcaktuar numrin e punonjësve referuar një përllogaritje të saktë të bërë referuar zërave të punimeve për objektin e prokurimit, orëve të punës (8 ore në ditë për çdo punonjës) afatit kohor të realizimit të kontratës si dhe shpërndarjes së punës. Në numrin e përcaktuar për fuqinë punetore janë përllogaritur stafi teknik dhe inxhinierik si dhe stafi administrativ. Nga përllogaritja e orëve të punës për çdo zë pune rezulton se për kryerjen e punimeve sipas grafikut të punimeve duhen 45 punonjës

Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështrirje **maj 2022 deri në korrik 2022**, tregon besueshmëri për autoritetin që, operatori do të përmbushë kontratën. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës

2.3.5 Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf teknik për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplomë, CV, si dhe të figurojnë në licencën dhe listëpagesat e shoqërisë për **muajin e fundit**, si mëposhtë:

- 1 (një) inxhinier Ndertimi
- 1 (një) inxhinier Gjeodet ose Topograf

Ky kriter do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, që OE i disponon punonjësit e mësipërm, do të dorëzohet vetëm nga operatori ekonomik i shpallur fitues përpara lidhjes së kontrates.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Numri i stafit kryesor teknik

si numri i inxhinierëve është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar punonjës të pajisur me dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik (të vlefshme) lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial apo nga subjekte juridike private të akredituara për çertifikimin e punonjësve , si mëposhtë ;

- **2 (dy)** punonjës teknikë ndertimi
- **7 (shtatë)** punonjës karpertiere
- **3 (Tre)** punonjës muratore

Për punonjësit e mësipërm duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme ; deshmia/çertifikata/diploma; deshmitë e kualifikimit të sigurimit teknik (të vlefshme), si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për **muajin e fundit**.

Ky kriter do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, që OE i disponon punonjësit e mësipërm, do të dorëzohet vetëm nga operatori ekonomik i shpallur fitues përpara lidhjes së kontratës.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqine minimale punetore të nevojshme për ekzekutimin e objektit. Kriteri për punonjësit e mësipërm lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, relacionin teknik dhe zërat e punimeve, duke krijuar besueshmërinë se kanë përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Për të përcaktuar numrin e punonjësve të kualifikuar të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, konkretisht VKM Nr. 629 Datë 15.07 2015“Për Miratimin E Manualeve Teknike Të Çmimeve Të Punimeve Të Ndërtimit Dhe Të Analizave Teknike Të Tyre” (I ndryshuar). Konkretisht numri I punonjësve është në përputhje me volumet e punës dhe llojit të tyre.

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar minimalisht:

- 2 (Dy) manovratorë të mjeteve të rënda, shoqëruar me kontratë pune të vlefshme, dëshmitë e aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda të ndërtimit dhe punimeve në tokë (të vlefshme) lëshuar nga DPSHTRR;

- 4 (katër) shoferë për kamiona (kategoria C minimale) dhe Çertifikatë e Aftësisimit Profesional, shoqëruar me kontratë pune të vlefshme, dëshmitë e drejtimit (të vlefshme) lëshuar nga DPSHTRR;

Manovratoret dhe shoferet mund të figurojnë në listpagesa ose mund të disponohen nga operatorët ekonomike edhe nepermjet kontraktimit për të cilët nuk është e nevojshme të jenë në listpagesat e shoqërisë.

Ky kriter do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, që OE i disponon punonjësit e mësipërm, do të dorëzohet vetëm nga operatori ekonomik i shpallur fitues përpara lidhjes së kontratës.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht: Vendosija e këtij kriteri për fuqinë punëtore është bërë në përputhje me zerat dhe volumet e preventivit, me afatin e zbatimit të punimeve sipas grafikut të punimeve, që është perlogaritur në një kohë të shkurtër i cili kërkon fuqi punëtore të shtuar dhe me mjetet e kerkuara për zbatimin me sukses të kësaj kontrate. Gjithashtu për profilin e manovratoreve është marrë në konsideratë direktë natyra e zerit të punimeve përkatëse të cilët mund të zbatohen vetëm nepermjet proceseve të mjeteve e makinerive të vecanta.

2.3.8 Disponimi ose mundësia e sigurt e disponimit në pajisjet/kapacitetet e mëposhtme teknike, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës:

Lloji i Makinerive	Sasia	
Kamion me vinc	1 copë	Pronesi ose me qera
Kamion vetëshkarkues 7-12 ton	1 copë	Pronesi ose me qera
Kamioncine deri në 3.5 ton	2 copë	Pronesi ose me qera
Fadrome me goma	1 copë	Pronesi ose me qera
Eskavator	1 cope	Pronesi ose me qera
Betoniere V=0.25 m ³	copë 3	Pronesi ose me qera
Fikse zjarri	10 copë	Pronesi ose me qera
Pompe suvatimi	copë 1	Pronesi ose me qera
Depozite uji	1 copë	Pronesi ose me qera

Matrapik	1 copë	Pronesi ose me qera
Trako	1 copë	Pronesi ose me qera
Trapan	1 copë	Pronesi ose me qera
Kuti tw ndihmws sw shpejtew	4 copw	Pronesi ose me qera

• **Të gjitha mjetet e lartpërmendura duhet të jenë shoqëruar me fotot përkatëse.**

Mjetet e lartpërmendura duhet të jenë në pronësi ose me qera dhe ofertuesi duhet të paraqesë deklarinimin për disponimin e makinerive të shoqëruar me dokumentat e mëposhtëm:

a) Aktin e pronësisë së mjetit përkatës;

ose

b) Kontratën e marrjes me qira të mjetit, shoqëruar me dokumentacionin përkatës të

pronësisë së mjetit që ka pronari, i cili e jep me qira. Kontrata e qirasë të jetë noteriale të përfshijë afatin e realizimit të kësaj kontrate.

- a) Per mjetet e mesiperme, kur jane ne pronesi, duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit lëshuar nga DPSHTRR (leje qarkullimi), certifikate pronesie, çertifikata e vlefshme e kontrollit teknik, siguracioni i vlefshem i mjetit, fotot e tyre ku te duken qarte mjetet e mesiperme dhe certifikatat e transportit per mjetet e transportit.
- b) Kur mjetet jane me qera, duhet të paraqitet kontrata noteriale e qirase, dhe bashkëlidhur te gjithë dokumentet e përshkruar me sipër. Kontratat e qerases duhet te përfshijnë te gjithë periudhën e realizimit te kontrates.

c) Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë se: Makineritë e mësipërme nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera. Kjo deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese duhet të përmbajë vendndodhjen e sakte të mjeteve në pronësi ose me qera me qëllim verifikimi.

Ky kriter do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, që OE i disponon mjetet e mësipërme, do të dorëzohet vetëm nga operatori ekonomik i shpallur fitues përpara lidhjes së kontrates.

Argumentimi : Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Numri dhe lloji i makinerive, paisjeve ne pronesi / qira janë vlerësuar si të nevojshme në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke ju referuar punimeve sipas standardeve, orëve të punës,

grafikut dhe kohëzgjatjes së punimeve, specifikimeve teknike. Për të zbatuar kontratën, operatorët ekonomik duhet të përmbushin kapacitetet teknike të pajisjeve dhe aseteve të tjera fizike, për këtë janë përcaktuar edhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët. Nëpërmjet kapaciteteve teknike operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative. Pajisje dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës si dëshmi për mjetet dhe pajisjet sipas specifikave. Përcaktimi i makinerive është bere referuar zërave të punimeve reflektuar ne tabelë sa më poshtë: Mjetet e mësipërme kërkohen: duke u bazuar në proceset e punës, volumet e punimeve të preventivit dhe grafikut të punimeve të kryera gjatë javës ku shënohet dhe piku i punimeve dhe duke u bazuar në shpërndarjen e punimeve në objekt dhe certifikatën e kontrollit teknik të mjeteve rrugore.

2.3.9 Operatori Ekonomik duhet te disponoje dhe paraqese certifikata te vlefshme:

- EN-ISO 9001 (*Sistemi i menaxhimit të cilësisë*) ose ekuivalent
- EN-ISO 14001 (*Sistemi i menaxhimit të mjedisit*) ose ekuivalent
- ISO 45001 (*Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë*) ose ekuivalent

(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, cdo anëtar i këtij bashkimi duhet të dorëzojë certifikata ISO sipas zërave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt-marrëveshjes).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenin 39, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Për vet natyrën e veçantë, vendndodhjes dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rëndësishme që operatorët si zbatues, të kryejnë veprimtarinë me standardet e kërkuara të cilësisë. Sistemi i menaxhimit të cilësisë, mjedisit dhe shëndetit dhe sigurisë në punë janë standarte që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përse kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës. Referuar në nenin 79 të ligjit 162/2020, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standartet për menaxhimin e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në punë

Për ISO 9001 - 2015; Kjo certifikate specifikon kërkesat për një sistem të menaxhimit të cilësisë, ku një operator ekonomik duhet të tregojë aftësinë e tij që vazhdimisht të sigurojë punë/mallra ose shërbime që plotësojnë kërkesat e aplikueshme ligjore dhe rregullatore, si dhe synon të rrisë kënaqësinë e konsumatorit nëpërmjet zbatimit efektiv të sistemit duke përfshirë edhe proceset për përmirësim të vazhdueshëm të sistemit dhe sigurimin e konformitetit të klientit dhe kushtet e aplikueshme ligjore dhe rregullatore si dhe meqënëse Bashkia Devoll si Autoritet Kontraktor kërkon që punimet që do të kyhen të jenë në cilësinë më të lartë është përcaktuar që kandidatët ofertues të jenë të pajisur me këtë standart cilësie.

Per ISO 14001 – 2015: Eshtë kërkuar që kandidatët ofertues të jenë të pajisur me standartin ISO 14001 – 2015 , standart ky që vlerëson sipas përkufizimit të tij përgjegjshmërinë e kompanive ndaj mjedisit dhe fokusohet në tre fusha kryesore:

- Standardet e Sistemit të Menaxhimit - që vlerësojnë nivelin e sistemit të zhvillimit dhe integritit të përgjegjësi ndaj mjedisit në të gjithë kompaninë,
- Standardet Operative - që masin harxhimin e burimeve natyrore dhe energjisë në proceset operative të kompanisë, dhe
- Standardet e Sistemit të Mjedisit - që masin ndotjet e ndryshme nga mbetjet.

Bashkia Devoll si Autoritet Kontraktor kërkon një menaxhim të aktivitetit përkushtuar parandalimit të ndotjes dhe të përmirësimit të ndikimeve mjedisore.

Për ISO OHSAS 18001:2007 ose ISO 45001-2018 Ky standart përcakton kërkesat minimale të shëndetit në punë dhe praktikën më të mira të menaxhimit të sigurisë. Ky lloj standarti konsiston në sigurimin e një sistemi shendetësor optimal dhe menaxhimin e sigurisë në punë. Kjo mund të ndihmojë për të vënë në vend politikat, procedurat dhe kontrollet e nevojshme për çdo lloj biznesi për të arritur kushtet më të mira të mundshme të punës, një linjë me praktikën më të mirë të njohur ndërkombëtare.

2.3.10 Leje Mjedisit tipi III.1.B ‘Menaxhim i mbetjeve’ për aktivitetin: ID 5.6 pika b) Magazinimi i mbetjeve në lidhje me zbatimin e veprimtarive të pikës 5.6 a ku të jenë të përfshirë kodet 20 02 02 (Dhera dhe gure) ;20 03 07 (Mbetje të vëllimshme);20 03 99 (Mbetje urbane të paspecifikuara)

Ne rast bashkimi operatorësh të pakten njëri nga operatorët duhet të jetë i pajisur me Lejen e mesipërme në raport me zërat e preventivit që ka marrë përse të kryeje;

Ne rast se kjo leje nuk disponohet nga operatorët ekonomike pjesëmarrës, AK me qëllim gjithëpërfshirjen dhe rritjen e konkurrencës do të pranojë paraqitjen e një kontrate Shërbimi nga subjektet të cilët disponojnë këto leje.

Argumentimi : Kërkesa e mesipërme është përcaktuar bazuar në pikën 2, të nenit 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”,

Qëllimi për vendosjen e këtij kriteri është të sigurojë një nivel të lartë të mbrojtjes së mjedisit, nëpërmjet parandalimit, minimizimit dhe kompensimit të dëmeve. Vlerësimin e ndikimeve negative mjedisore në kohën e duhur dhe parandalimin e tyre. Duke qënë se punimet do të kryhen pandërprerë aktivitetin e përditshëm të punës së drejtorisë dhe në prani të shumë personave afër dhe Brenda kantierit të ndërtimit dhe duke pasur parasysh vendin e ndërtimit, është parë e nevojshme disponimi i ekspertit të ndikimit në mjedis. Në pikën 4, Nenin 24 të ligjit Nr.10 440, datë 07.07.2011 “Për Vlerësimin E Ndikimit Në Mjedis” përcaktohet se licencat e këtyre ekspertëve përfshihen në kategorinë III.2 të shtojcës së ligjit për licencat. Veprimtaritë e nënkategorisë III.2.A specifikohen në vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe në auditimin mjedisor.

”Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë” dhe nenin 41, pika 4, gërma a,) të ligjit nr.10081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, VKM Nr. 538, datë 26.05.2009, “Për Licencat dhe Lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta” e ndryshuar, Ligjin Nr. 10 463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar, Ligji nr. 10 431, date 9.6.2011” Per mbrojtjen e mjedisit” Ligjin Nr 10448, datë 14.07.2011, “Për Lejet e Mjedisit”, Ne baze te Ligjit Nr .9010, date 13.2.2003 “Per administrimin mjedisor te mbetjeve te ngurta”i ndryshuar pasi licenca me (kodi III.1.B eshte ne perputhje me zerat e preventivit te realizimit te sherbimit dhe specifikimet teknike ku kerkohet pastrimi, grumbullimi dhe transporti i mbetjeve te ngurta.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim

Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet Teknike per proceduren respektive jane hartuar nga drejtoria e projekteve, pjese perberese e struktures se Bashkise Devoll, qe ka hartuar edhe projektin perkates te zbatimit duke gene elemente perberes te tij. Ne hartimin e tyre jane marre ne konsiderat kerkesat ligjore te fushes se planifikimit dhe zhvillimit te territorit si dhe normat perkatese te Ligjit nr. 9290 , date 7.10.2004 “Për produktet e ndërtimit” i ndryshuar dhe Vendim i KM nr.312, datë 5.5.2010 Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier” si dhe kerkesat e ligjit te Ligjit Nr. 10480 datë 17.11.2011 , "Për sigurinë e përgjithshme të produkteve joushqimore".

Specifikimet Teknike jane pjese e setit te dokumentave te ngarkuara ne SPE per proceduren respektive.

Fondi Limit i perlogaritur per kete procedure eshte hartuar ne baze te VKM nr 629 date 15.07.2015 ''Per Miratimin e Manualeve Teknike te Cmimeve te Ndertimit dhe analizat teknike te tyre'',

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Njesia e Prokurimit: